

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e -VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
14 shtator 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Teuta Aruçi Shartari dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Shkëlzen Feka.

*Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtive (Refik Maloku, Miran Halili, Sylejman Mehollı, Berat Sadiku), Xhavit Mehmeti, nga zyra për integrime evropiane, Isa Latifi, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Selim Musa, nga Drejtoria për Inspektim, përfaqësues nga UN HABITAT si dhe nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu tha lidhur me pikën 2 të rendit të ditës "Shqyrtimi i draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2021", ka ardhur një njoftim nga Ministria e Financave ku kërcohë që kjo pikë mos të procedohet për shqyrtim derisa të dërgohet Qarkorja 2021/03.

Ai tha se kishte kërkesë edhe për shtyrje të mbledhjes së KPF-së, por nuk e pashë të arsyeshme që ta shtyjmë mbledhjen. Kurse, përbuxhet do ta mbajmë një mbledhje tjeter të KPF-së.

Ai tha se kanë ardhur edhe dy pika për shqyrtim: Kërkesë nga klubit "Fc Vushtrria" dhe një kërkesë nga Bajram Musliu.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së –** propozoi që të futet në rend të ditës ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të kuvendit për ndarjen e mjeteve financiare për fëmijët e porsalindur, pasi që me vendimin e kuvendit të miratuar në muajin shkurt, nuk parashihet kompensimi nga 1 janari 2020.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së –** ndoshta ka mundur të rrjedh ndonjë gabim teknik, sepse ka qenë që nga 1 janari 2020 të fillojë kompensimi për fëmijët e porsalindur. Prandaj, nuk ka asgjë të keqe që ta plotësojmë këtë vendim që të mos dalim keq para qytetarëve.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 korrik 2020;
  2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershori 2020;
  3. Shqyrtimi i Draft – Planit të pjesëmarrjes qytetare – Udhëzues i përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal (**shqyrtimi i parë**);
  4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike;
  5. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrje-shirjeve;
  6. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;
  7. Shqyrtimi i kërkesës nga klubi “Fc Vushtrria”;
  8. Shqyrtimi i kërkesës së Bajram Musliut lidhur me pretendimet për shkelje ligjore me rastin e ndërtimit të një objekti të banimit kolektiv;
  9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër 01 Nr:47/20 i datës 27.02.2020;
  10. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 korrik 2020.

**Komitetti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 16 korrik 2020.**

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën janar-qershori 2020.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se është një raport i mirë, por ka disa gabime teknike dhe disa gjëra që nuk janë futur në raport dhe përkundrejtësohen.

Sektori i bujqësisë

Nr. i përfituesve me serra është 151, kurse participimi është 149 ( $200 \times 149 = 29,800.00\text{€}$ ).

Ta dimë pse këta dy përfitues nuk kanë participuar, cila është arsyja?

Sektori i pylltarisë- A është gjendja momentale e drunjve në depo ( $33.20\text{m}^3$ ) Ai pyeti se a ka pasur ndonjë metër kub druri para 1 janarit 2020?

Shëndetësia- ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në zonën urbane te tregu aktual-ndoshta kam harruar kur e kemi votuar dhe kur ka qenë si projekt?

Lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid 19, qeveria komunal është ka deklaruar se kanë bërë një menaxhim të mirë të situatës. Por, kemi një anëtarë të kuvendit që ka qenë i infektuar me Covid 19, ku sipas tij ekipet e QKMF-së nuk kanë shkuan për trajtim.

Drejtoria për Urbanizëm – sektori i urbanizmit

Cili është dallimi në mes të refuzimit dhe të hedhura poshtë

Pyetje: Cila është arsyja që ka kaq pak të hyra për legalizimin e objekteve ( $2062.45\text{€}$ )?

Pyetje: Çka nënkupton refuzime të hapësirave publike?

Pyetje: Projekt i Tregut për prodhuesit vendor, a ka të bëjë kjo me modelin e Tregut të Tiranës?

Pyetje: Sa certifikata të legalizimit janë lëshuar gjatë periudhës janar – qershor 2020?

Pyetje: A janë lëshuar leje të legalizimit për pronat që janë të ndërtuara në komasacion?

Pyetje: Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik, kurse asfaltimi i rrugëve më 47 fshatra tjera të Komunës së Vushtrrisë, pse është veçuar fshati Reznik, pse është bërë ky dallim në raportin për situatën ekonomiko – financiare për periudhën janar – qershor 2020?

Shërbime Publike – komunikacion (faqe 17)- tabela ku janë paraqitur kilometrat e kaluara dhe karburantet e harxhuara për automjetet për periudhën janar – qershor 2020.

Gjatë kësaj periudhe kemi 224623 km dhe 7099 litra karburante të harxhuar që i bie mesatarja 3.16 (l/100km) e jo 8.71 (l/100km) siç është paraqitur në tabelë.

A kemi të bëjmë me gabim teknik tek tabela?

Inspektimet- kemi katër inspektor të tregut, të cilët kanë bërë 174 procesverbale, 88 aktvendime/urdhëresa, kurse asnjë fletëparaqitje në gjykatë, ndërsa kemi vetëm një inspektor sanitari, i cili ka bërë 72 procesverbale, 407 aktvendime/urdhëresa dhe 1 fletëparaqitje në gjykatë, kemi dy inspektor të komunikacionit që kanë bërë 54 procesverbale, 6 aktvendime/urdhëresa, kurse asnjë fletëparaqitje në gjykatë.

Diçka nuk është në rregull, sepse këta inspektorë kanë dalë gjatë kohës së pandemisë nëpër TV dhe kanë deklaruar që kanë shqiptuar fletëparaqitje.

Tek Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ku në këtë raport gjashtëmujor mos të përmenden qentë endacakë është shqetësuese.

Tek informata për mbrojtje nga Covid 19

A është shfuqizuar vendimi i shtabit emergjent për mbrojtje nga virusi Covid 19 i dt.12.03.2020, me të cilin parashihet zvogëlimi i stafit punues në organet e administratës së komunës?

**Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – tha se numri i përfituesve me serra është 151, kurse 2 serra ua kemi dhënë organizatës Handikos dhe ata janë të liruar nga pjesa e participimit.

Ndërsa, gjendja e drunjve në depo është ajo që është paraqitur në raport.

**Sylejman Mehollı, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – deklaroi se sa i përket Qendrës së Mjekësisë Familjare që po ndërtohet në zonën urbane te tregu aktual, kuvendi i komunës me vendim e ka caktuar lokacionin, pastaj me një vendim tjetër është bërë ricaktimi i lokacionit. Po ashtu, edhe në buxhetin e vitit 2019 është aprovuar buxheti për investim në këtë QMF.

Ndërkaq lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid 19, ai tha se kjo dëshmohet përmes raporteve dhe numrit të shërbimeve që po iu ofrojmë qytetarëve në shtëpi. Sa i përket numrit të banorëve si komunë, në krahasim me komunat tjera që janë afersisht me numër të njëjtë të banorëve, jemi pakrahasimisht komunë që kemi ofruar shërbime në shtëpi me disa ekipe. Lidhur me shqetësimin që e ngriti Neziri se një anëtarë të kuvendit i prekur me Covid 19 nuk i është ofruar ndihmë nga ekipet mjekësore, Mehollı deklaroit se ekipet mjekësore i kryejnë vizitat në shtëpi sipas radhës dhe nuk kanë mundësi në të njëjtën kohë të arrijnë tek të gjithë. Prandaj, shërbimet shëndetësore nuk njojin pozita politike as tituj tjerë e as orientime politike, fetare dhe ideologjike, por shërbimet kryhen mbi parimin e profesionalizmit, duke respektuar betimin e Hipokratit.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – nuk thashë që është dashur të vizitohet si anëtar i kuvendit, por si qytetar i Komunës së Vushtrrisë.

Ekipet shëndetësore e kanë marrë epitetin <heronj> nga kuvendi i komunës dhe kjo flet shumë.

**Sylejman Mehollı, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – u shpreh se, familja e anëtarit të kuvendit të komunës që ka qenë i infektuar me Covid 19, ka pasur një telashe sa i përket komunikimit me shërbimin e urgjencës, për shkak se banojnë në një pjesë të afërt me Komunën e Skënderajt dhe kontakti me numrin 194 i ka lidhur me urgjencën e Skënderajt për shkak të afersisë së banimit dhe ky është problem teknik i postës, tha ai. Përndryshe, sa herë më ka kontaktuar, shërbimet e urgjencës kanë shkuar në vizitë dhe i urojmë shërim të shpejtë.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

3. Shqyrtimi i Draft – Planit të pjesëmarrjes qytetare – Udhëzues i përgjithshëm për pjesëmarijen e qytetarëve në nivel lokal (**shqyrtimi i parë**).

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se është një dokument paksa i ekzagjeruar, por i përgatitur shumë mirë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ecurinë e Hartës zonale komunale dhe zonës historike.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Informatës për procesin e korrije-shirjeve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – pyeti se sa përqind të nevojave vjetore të popullatës së Vushtrrisë i mbulon kjo sasi e sipërfaqes së grurit?

**Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – theksoi se nuk kemi statistika të sakta, por nevojat e popullatës sonë mbulohen me këtë rendiment.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së** - tha se nga përvoja e kaluar, komuna jonë çdo herë e ka nxjerr miellin për veti, ka ndodhur që ka pasur rezerva deri në 1 vit e gjysmë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave.

**Melihate Basholli - Latifi, anëtare e KPF-së** – tha se në faqën 2, kemi një rast kur dy studentë me kushte të barabarta, pra me notë mesatare të njëjtë dhe pikë të barabarta, është marrë për bazë

koha që ka aplikuar më herët njëri student dhe i është ndarë bursa. Ajo pyeti se a është e specifikuar kjo çështje në rregullore, apo ka dalë gjatë punës? Po ashtu, ajo pyeti se a ka pasur ankesë nga studenti tjetër jopërfitues?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**- tha se nuk e kam shikuar se a është e përfshirë në rregullore kjo çështje, por ka mundësi të jetë aplikuar parimi i vjetër romak: Cili është i pari për nga koha, është më i fortë për nga e drejta.

**Melihate Basholli - Latifi, anëtar e KPF-së** – theksoi se afati kohor nuk është përcaktues dhe konsideroj se këtij studenti i është bërë e padrejtë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se ndoshta ka mundur të bëhet edhe me short, sikurse në rastin e zgjedhjeve dhe ka mundësi që ishin pajtuar edhe dy kandidatët.

**Gresa Muli, anëtar e KPF-së** – tha se prej që ka qenë anëtar në këtë komision, kam insistuar që të ndryshohet rregullorja. Kur ka qenë konsultimi publik, i kemi dhënë sugjerimet tona, por nuk janë marrë përbazë.

Lidhur me këtë rast, edhe unë pajtohem që t'iu ndahet bursa dy studentëve me kushte të barabarta.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se është fat i mirë që në komunën tonë kemi studentë me notë aq të lartë mesatare. Nuk e di a kemi ndonjë mundësi ligjore që t'ua ndajmë të dy studentëve bursën, të bisedohet me Drejtorinë për Arsim.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i kërkesës nga klubii “Fc Vushtrria”.

**Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – tha se nuk mund të përzihemi në kompetencat e klubit se ai është organizatë joqeveritare.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se nuk e di pse ka ardhur kjo kërkesë prej klubit, sepse me klub ne nuk kemi punë. Por, me stadiumin kemi punë, sepse është pronë komunale dhe komuna menaxhon me këtë pronë. Në media e kemi parë ku është deklaruar se stadiumi është mbyllur. A është e vërtetë kjo?

Prandaj, lidhur me këtë temë konsideroj se jemi të papërgatitur të bisedojmë sot.

A është kjo kërkesë e klubit “Fc Vushtrria”, apo kërkesë e një zyrtari të klubit?

**Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – theksoi se kjo kërkesë ka ardhur nga një zyrtar i klubit. Stadiumi i Vushtrrisë është i qytetarëve dhe se nuk është i mbyllur. Ajo tha se stadiumi aktualisht menaxhohet nga klubii i futbollit, ku komuna ia ka dhënë në shfrytëzim klubit, sepse kështu e kam trashëguar këtë çështje, tha ajo.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – me çfarë vendimi shfrytëzohet stadiumi nga klubii?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**- tha se nuk ka vendim të kuvendit të komunës për shfrytëzim të stadiumit nga klubii i futbollit, sepse stadiumi është pronë komunale.

Drejtoresha duhet ta sjellë një plan në kuvend për mënyrën e menaxhimit të stadiumit.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – të hulumtohet nëse ekziston ndonjë dokument për shfrytëzimin e stadiumit nga klubi.

Drejtoresha është dashur të reagojë kur është thënë në media se është mbyllur stadiumi.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando që të procedohet për shqyrtim të mëtejmë tek Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, pasi që as Kuvendi i Komunës e as Komiteti për Politikë dhe Financa nuk kanë kompetenca të përzihen në çështjet e brendshme të klubit.*

8. Shqyrtimi i kërkesës së Bajram Musliut lidhur me pretendimet për shkelje ligjore me rastin e ndërtimit të një objekti të banimit kolektiv.

**Selim Musa, inspektor i ndërtimit në Drejtorenë për Inspekte** – lidhur me pretendimet e ankuesit se objekti në fjalë nuk posedon leje ndërtimore, ai the se ky objekt posedon leje ndërtimore të lëshuar nga urbanizmi, dhe se gjatë inspektimit deri në këtë fazë objekti është në rregull.

Ai sqaroi se aktualisht jemi duke e hulumtuar çështjen edhe në Drejtorenë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit se a i është dhënë leja ndërtimore sipas kritereve.

Palën e kemi njoftuar me shkrim lidhur me kërkesën që e ka dërguar.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando që të procedohet për shqyrtim të mëtejmë tek Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe tek Drejtoria për Inspekte.*


9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër 01 Nr.47/20 i datës 27.02.2020.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekmando që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **15:30**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i KK-së dhe i KPF-së